



**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

Nr. 09

Datë: 18. 02. 2020. Ora: 16:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Eshref Vishi, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Artan Asllani.

SKQZ: Yll Buleshkaj, u.d. i Kryeshefit

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

**RENDI I DITËS**

**1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**

- Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.08/2020,

**2. Aktivitetet e ZRPP-së;**

**3. Raporti i Këshillave të KQZ-së:**

- **Këshilli për Operacionet Zgjedhore:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i specifikimeve teknike për shtypjen e fletëvotimeve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës,
- Shqyrtimi dhe miratimi i formularëve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës,
- Shqyrtimi dhe miratimi i Doracakut për procedurave e votimit dhe numërimit për Zgjedhjet për Kryetar Komune.

#### 4. Të ndryshme

##### **1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:**

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.08/2020

**Valdete Daka:** Përshëndetje të gjithëve ! A ndokush vërejtje, sugjerime, propozime lidhur me rendin e ditës ? Nëse nuk ka, kush është për këtë rend dite?  
*Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës...*

Në vazhdim, anëtarët e KQZ-së miratuan proceverbalin nga mbledhja nr.08/2020 e KQZ-së.

##### **2.Aktivitetet e ZRPP-së:**

**Yll Buleshkaj:** Zyra, dje deri në orën 18:00 ka pranuar aplikimet për kandidatë në zgjedhjet e 15 marsit për kryetar komune në Podujevë. Aplikimet i kanë sjellë një kandidat nga Lidhja Demokratike e Kosovës, një kandidat nga Lëvizja “Vetëvendosje”, dhe një kandidat nga Partia Demokratike e Kosovës. Do t’i kemi tre kandidatë, dhe ne si zyre jemi në procedim të këtyre aplikimeve mbi bazën e kornizës ligjore. Subjektet, ojq-të si dhe organizatat e ndryshme mund të aplikojnë si vëzhgues...! Edhe një çështje: Si sekretariat, jemi në proces të pranimit të aplikacione të votuesve jashtë vendit, deri më tani kemi 30 aplikime, dhe ne po i procedojmë këto aplikacione...

**Valdete Daka:** Vazhdojmë me raportin e këshillave të KQZ-së...

##### **3.Raporti i Këshillave të KQZ-së:**

###### *Këshilli për Operacionet Zgjedhore*

Shqyrtimi dhe miratimi i specifikimeve teknike për shtypjen e fletëvotimeve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës:

**Alim Rama:** Këshilli, ka shqyrtuar specifikat teknike për shtypjen e fletëvotimeve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës. Këto specifika, ne i rekomandojmë për aprovim. Po ashtu, këshilli ka bërë edhe shqyrtimin e formularëve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar komune në Podujevës, dhe i ka miratuar pas shqyrtimit. Rekomandojmë që të aprovohen. Së fundmi, kemi shqyrtuar edhe doracakun për procedura për votim dhe numërim për zgjedhjet për kryetar komune, dhe e ka aprovuar.

**Arianit Elshani**: Sic kam kërkuar edhe në mbledhje të DOZ-it, kërkoj edhe njëherë nga stafi i administratës, nga këshilli, si KQZ që t'i kushtojmë një rëndësi të veçantë formularëve duke e pasur parasysh zgjedhjet e fundit të jashtëzakonshme, gabimi në formularë i ka kushtuar subjektit tim, PDK-së dhe partive të tjera. Andej, edhe njëherë kërkoj një vëmendje të veçantë sa i përket dizajnit, të shqyrtohen dhe të kihet vëmendje e veçantë në dizajnimin dhe shtypjen e formularëve...

**Valdete Daka**: Para se të printohen, formularët do të shqyrtohen edhe njëherë...

**Eshref Vishi**: A ka pas ndryshime në doracakë, intervenime apo është i njëjti nga zgjedhjet e kaluara...?

**Alim Rama**: Doracaku veç, është i modifikuar që me i trajtua vetëm zgjedhjet komunale në Podujevë. Materiali, është i njëjtë dhe janë bërë modifikimet e duhura...

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan një nga një specifikat teknike për shtypjen e fletëvotimeve, formularët për VV dhe QV, dhe doracakun për procedurat e votimit dhe të numërimit.*

#### **4.Këshilli për Cështje Ligjore**

Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimeve

**Arianit Elshani**: Këshilli, në mbledhjen e tij të mbajtur ka shqyrtuar kërkesën për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal në Gjakovë, konkretisht, z. Bekim Jupa, të zëvendësohet me Liridon Dulen. Kërkesa është shqyrtuar, dhe këshilli rekomandon këtë zëvendësim.

**Valdete Daka**: Kush është për që, anëtarit të kuvendit komunal në Gjakovë, Bekim Jupa, të zëvendësohet me Liridon Dulen nga subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës.

Anëtarët e KQZ-së, kanë miratuar këtë rekomandim.

**Arianit Elshani**: Këshilli ka shqyrtuar edhe kërkesën e Presidentit të Kosovës për zëvendësim të kandidatit për deputet të Kuvendit të Kosovës z. Ramush Haradinaj nga subjekti politik AAK, të zëvendësohet sipas radhës me z. Gazmend Abrashi. Ne si këshill, rekomandojmë për zëvendësim.

**Sami Kurteshi**: Në këshill, unë jam përmbajtur nga votimi, në fakt kam abstenuar sepse, nuk e kisha listën e plotë të kandidatëve, nuk e dija radhitjen...! Tani, e kam listën, dhe jam për...!

**Sami Hamiti**: Ky vendim, po vjen për herë të dytë. Nuk e di pse nuk është bërë procedimi në kuvend, pra është mirë që presidenca dhe kuvendi të bashkëpunojnë, sepse ne njëherë e kemi bërë zëvendësimin...

**Valdete Daka**: Dihet që kur ne e kemi zëvendësuar, Kuvendi nuk ka qenë i konstituuar, dhe besoj kjo ka qenë arsye e mos komunikimit...

**Sami Hamiti**: Konsideroj që duhet të shihet mirë pozicioni i një deputeti të zgjedhur që nuk done me qenë deputet, dhe t'i nuk mundesh me zor me e ba deputet...!

**Ibrahim Selmanaj**: Ndaj shqetësimin tim, mendoj që është një neglizhencë që në të ardhmen të mos përsëritet, dhe kjo të mos përsëritet...

Valdete Daka: Ne, do të bëjmë rekomandimin tonë për kandidatin e radhës për deputet të Kuvendit, dhe sipas votave i bie që Gazmend Abrashi të jetë kandidat i radhës për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

## **5.Këshilli për Buxhet dhe Financa**

**Sami Hamiti**: Në këshill, ne kemi trajtuar dy çështje të rëndësishme në punën tonë. Si pikë e parë, është njoftimi lidhur me çështjen e zhvillimeve për miratim të buxhetit nga ana e Qeverisë për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujevë. Si KQZ, ju e dini që me kohë e kemi shqyrtua dhe miratua. Ne, e kemi drejtua një draft – buxhet në Kryeministri, në Ministrinë e Financave dhe në thesar, por sot jemi në ditën e dhjetë kur e kemi dorëzua buxhetin, dhe nuk kemi aprovim të buxhetit. Afatet janë të shkurtër, dhe ne jemi në një situatë të pakëndshme...! Nga trajtimi në këshill, vjen që kryetarja me shefin ekzekutiv, të bëjnë edhe një kërkesë që të bëhet edhe njëherë shqyrtimi në Qeveri, dhe atë jo më larg se nesër...

I kemi praktikat, tha z. Hamiti, dhe ne vec jemi në ditën e dhjetë sepse, ndryshe rrezikohet mbajtja e zgjedhjeve... Pra, të bëhet edhe një shkresë urgjente..

Po ashtu, kemi pas edhe një njoftim lidhur me qarkoren 03/2020 për kufijtë buxhetor lidhur me vitin 2020, dhe 2022. Edhe për këtë, në aspektin financiar - material, dallimi është i vogël. Por, nga projeksioni, janë hequr gjashtë vende pune...Është ulur numri në 82...Por, duhet të bëhet trysni që të mos bëhet zbritja, sepse nuk ka vende alternative, janë vende që patjetër duhet të jenë...sepse nëse hiqen, nuk do të kemi zyrtar...Do të shpallen konkurse, sepse ne kemi nga një zyrtar...

**Eshref Vishi**: Pajtohem me diskutimin e Samiut, sepse mos miratimi i buxhetit e rrezikon këtë proces zgjedhor dhe, aktivitetet zgjedhore të cilat i kemi me plan nuk mund të nisnin, dhe nuk mund të zhvillohen pa buxhet dhe pa zotime buxhetore. Do t'ishte mirë që një komunikim të ishte më se urgjent i KQZ-së me Qeverinë, përkatësisht me Ministrinë e Financave në mënyrë që mos ta rrezikojmë këtë proces zgjedhor në të cilin, ne vec kemi hy...

**Yll Buleshkaj**: Asnjëherë nuk ka ndodh që një buxhet i yni të merr kaq gjatë kohë, dhe veprimi i ministrisë është i pashembullt, sidomos që të mos kemi informim kthyes. Para pak minutash, mora informacion nga ministri se nuk do të ketë buxhet shtesë...Kërkoj një takim për të enjten me mua që ta informojë, dhe kështu ne kemi hyrë në një zonë të kuqe...

Në debat lidhur me mos miratimin e buxhetit nga Ministria e Financave, debatuan apo dhanë mendime, analiza dhe konstatime lidhur me problemin e krijuar në shumë aspekte kundrejt përgatitjes për mbajtjen e zgjedhjeve në Podujevë: Valdete Daka, Sami Hamiti, Čemailj Kurtiši, dhe Arijanit Elshani.

## **6.Të ndryshme**